



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASENIT LUMOR VJOSË

Nr. Serial 000014

AUTORIZIM
PËR VEPRIMTARI TË TJERA NË BRIGJE DHE NË SHTRATIN E BURIMIT
UJOR

Nr. 58/₇ Prot., datë 22 / 07 / 2025

Miraturar me:
VENDIM TË KËSHILLIT TË BASENIT LUMOR VJOSË

Nr. 4 , datë 17 / 07 / 2025

Emri i individit/subjektit:	“BASHKIA SELENICË”
I regjistruar si subjekt me këto të dhëna (NID/ NIPT):	K56703212G
Baseni Lumor:	VJOSË
Kodi i Trupit Ujor:	
Qarku:	VLORË
Bashkia/ Njësia administrative:	SELENICË
Koordinatat:	Koordinatat e urës (KRGJSH)
	X= 464607.70 Y= 4475840.79 Z= 73.25 m.m.n.d
	X= 464506.21 Y= 4475860.05 Z= 73.25 m.m.n.d

Lloji i burimit ujqor ku do të kryhet veprimtaria: **Lumi Shushicë**

Lloji i veprimtarisë që do të kryhet: **Ndërtimi i urës në fshatin Vodicë mbi lumin Shushicë**

Kufizime në ushtrimin e veprimtarisë (nëse ka) **Sipas Vendimit dhe kushteve të posaçme të autorizimit**

Periudha e vlefshmërisë: **Nga data e miratimit deri në fillimin e zbatimit në terren, në çdo rast jo më shumë se 2 (dy) vjet**

Hyrja në fuqi: **Pas publikimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve.**

KRYETARI

PLATOR NESTURI



Nes Nesturi

Kushtet e posaçme të autorizimit për veprimtari të tjera në brigje dhe shtratin e burimit ujor

1. Të përdorë ujërat në mënyrë racionale, duke shmangur mbetjet dhe duke mos dëmtuar mjedisin;
2. Të përdorë ujërat vetëm për qëllimet, për të cilat i është dhënë autorizimi;
3. Të paguajë të gjitha kostot, taksat, tarifat në lidhje me përdorimin e ujit;
4. Të instalojë dhe mirëmbajë me shpenzimet e veta pajisjet për matjen e sasisë së ujit të përdorur, në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga organi përkatës që ka lëshuar lejen (kur është e aplikueshme);
5. Të regjistrojë vëllimin e materialit të zhvendosur, ujit të përdorur, përfshirë dhe rrjedhën e kthyer;
6. Të japë të dhëna dhe informacion për përdorimin e ujit sa herë që i kërkohet nga organet e ngarkuara për menaxhimin e burimeve ujore;
7. Autorizimi nuk mund të transferohet një subjekti tjetër pa miratimin e organeve të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore;
8. Të respektohen kushtet higjieno – sanitare dhe të mbrojtjes së mjedisit;
9. Të mos dëmtojë brigjet dhe shtratin e burimit ujor;
10. Të mos ndryshojë rrjedhën natyrore të burimit ujor;
11. Të bashkëpunojë dhe të mos pengojë kryerjen e kontrolleve nga autoritetet përkatëse të ujit;
12. Të lejojë rrjedhjen ekologjike të miratuar (kur është e aplikueshme);
13. Të sigurojë marrjen e menjëhershme të masave dhe veprimeve për të minimizuar, ose parandaluar ndonjë ndikim në mjedisin ujor, ose në brigje në rast të një aksidenti, apo incidenti;
14. Të kompensojë dëmin e shkaktuar dhe të rikthejë mjedisin ujor në gjendjen e mëparshme;
15. Të mos çënojë faunën dhe florën ujore e tokësore dhe të marrë masa për mbrojtjen e specieve të rralla;
16. Të sigurojë, nga pikëpamja sasiore dhe cilësore, kushte për të mundësuar përdorimin burimit ujor nga subjekte të tjerë;
17. Të zbatojë parimet dhe kushtet e tjera për veprimtarinë, të përcaktuara në ligjin për burimet ujore.